

Dublin Office:
22 Upper Ormond Quay,
Dublin 7, Ireland
Ph: +353 (0)1 872 0008
Fax: +353 (0)1 874 8032
E-mail: translations@wordperfect.ie
Web: www.wordperfect.ie

Cork Office:
14 Penrose Wharf,
Cork, Ireland
Ph: +353 (0) 21 4861404
Fax: +353 (0) 21 4861303
Lo-call: 1890 707 707 (24hrs)
E-mail: cork.translations@wordperfect.ie

**International Protection Office
Irish Naturalisation and Immigration Service
79-83 Lower Mount St.
Dublin 2, D02ND99**

e martë, 02 tetor 2018

To Whom It May Concern:

This is to certify that the English to Albanian translation, reference “GDPR Privacy Notice -IPO (PP) 52 Rev 1” is a true & accurate translation. It reflects the writing style, punctuation and phrase structure used in the original text.

Yours sincerely,

Translation PM
Word Perfect Translations





Zyra për Mbrojtje Ndërkombëtare

Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Njoftim mbi Privatësinë

1. Të dhënat që ju jepni do të grumbullohen nga Zyra për Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO) dhe Shërbimi Irlandez i Naturalizimit dhe Imigracionit (INIS) (pjesë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë). Të dhënat e detajuara të konitit të të dhënave janë:

**International Protection Office
Irish Naturalisation and Immigration Service
79 – 83 Lower Mount Street
Dublin 2
D02 ND99**

2. Të dhënat personale të vëna në dispozicion nga ju për Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare mund të përdoren për qëllim të vlerësimit të së drejtës tuaj që të pranoheni për mbrojtje ndërkombëtare dhe, nëse është e përshtatshme, për lejeqëndrimin e shkallën së parë, në përputhje me kornizën ligjore adekuate. Kjo përfshin të dhënat që ju keni vënë në dispozicion tek *Pyetësori i Aplikimit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO2)* dhe çdo të dhënë personale tjetër të cilën ju e keni vënë në dispozicion të IPO-së në ndonjë formë apo mënyrë tjetër. Nëse është e nevojshme, IPO dhe Shërbimi Irlandez i Naturalizimit dhe Imigracionit/Ministria e Drejtësisë dhe Barazisë gjithashtu mund t'i përdorin të dhënat të cilat i jepni në IPO2 dhe në korrespondencën e ndërlidhur, si pjesë e ndonjë reference të ardhshme lidhur me statusin tuaj të imigracionit apo shtetësisë.
3. Baza jonë ligjore për grumbullimin dhe procesimin e këtyre të dhënave është si vijon:
 - i. Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015 dhe Rregulloret e bëra në përputhje me atë
 - ii. Rregulloret e Bashkimit Evropian (Sistemi i Dublinit) 2018
 - iii. Rregulloret e Komuniteteve Evropiane (Që pranohen për Mbrojtje) 2006
 - iv. Rregulloret e Bashkimit Evropian (Mbrojtja me princip të Subsidiaritetit) 2013, si të ndryshuara
 - v. Rregullorja e Dublinit e Bashkimit Evropian
 - vi. Rregullorja Eurodac e Bashkimit Evropian

Albanian

4. Të dhënat mund të ndahen edhe me Shtetet tjera të cilat përdorin Rregulloren e Dublinit tëBE-së dhe Rregulloren Eurodac tëBE-së, nëse aplikimiuaj për mbrojtje ndërkombëtare bie nën kornizën e atyre Rregulloreve tëBE-së.
5. Të dhënat personale të cilat jepen do të ruhen në mënyrë të sigurt nëIT serverate Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë. Përveçshpërndarjessë të dhënave brenda vendit me Shërbimin Irlandez të Naturalizimit dhe Imigracionit/Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë, aty ku është e përshtatshme të dhënat mund të ndahen edhe me zyra/agjencitjera qeveritare përfshirë:

- a. An Garda Síochána(Policinë)
- b. Këshillin për Ndihmë Ligjore
- c. Ministrinë për Punësim dhe Mbrojtje Sociale
- d. Tusla – Agjencia për Fëmijë dhe Familje
- e. Shërbimin Ekzekutiv Shëndetësor

Informacionet mund të ndahen edhe me agjencitë cilat kryejnë shërbimet e përkthimit.

6. Të dhënat personale të cilat jepen mund të ndahennjëkohësisht edhe me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë në lidhje me mandatin e tyre për të mbështetur procesin e mbrojtjes ndërkombëtare.
7. Kontakti për çdo pyetje lidhur me këtë Njoftim është:

**International Protection Office
Irish Naturalisation and Immigration Service
79 – 83 Lower Mount Street
Dublin 2
D02 ND99.**

8. Këto të dhëna do të ruhen në përputhje me planin e ruajtjes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë dhe kërkesat e Aktit për Arkivat Kombëtare 1986.
9. Mund të kërkonti një kopje të të dhënave personale të cilat i mbajmë ne. Këtë mund ta bëni duke plotësuar formularin e Kërkesës për akses në subjekt, të cilin mund ta gjeni këtu [http://www.justice.ie/en/JELR/Pages/Data Protection](http://www.justice.ie/en/JELR/Pages/Data%20Protection) apo tek çdo zyrë publike e Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë, dhe duke e dërguar tek subjectaccessrequests@justice.ie apo me postë tek Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë,në adresën tek paragrafi 11 mëposhtë. Do të kërkohet nga ju që të vërtetoni identitetin tuaj para se t'ju jepet ndonjë e dhënë.
10. Keni të drejtë të korrigjoni ndonjëpasaktësi në të dhënat tuaja. Për ta bërë këtë duhet t'i shkruani Zyres për Mbrojtje Ndërkombëtare të Shërbimit Irlandez të Naturalizimit

dhe Imigracionit tek adresa e dhënë në paragrafin 1 më lartë, duke ia dokumentuar pasaktësitë të cilat duhet të korrighohen.

11. Aty ku është e përshtatshme, keni të drejtë tësiguroheni për fshirjen e të dhënave dhe/apo ndalimin e procesimit të të dhënave tuaja, si dhe të drejtën që të kundërshtoni procesimin e të dhënave tuaja. Për më shumë, keni të drejtë që të ankoheni tek Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave. Mund të gjeni më shumë detaje lidhur me të drejtat tuaja për mbrotjen e të dhënave tek Rregullorja e Mbrojtjes së të Dhënave pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë, të cilën mund ta gjeni këtu [http://www.justice.ie/eng/JELR/Pages/Data Protection](http://www.justice.ie/eng/JELR/Pages/Data%20Protection).

Mund ta kontaktoni Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Barazisë me postë:

**The Data Protection Officer
Department of Justice and Equality
51 St. Stephen's Green
Dublin 2
D02 HK52**

ose

me anë të emailit: dataprotectioncompliance@justice.ie

12. Ky Njoftim mbi Privatësinë zëvendëson informacionin mbi mbrojtjen e të dhënave tek *Broshura Informative për Aplikuesit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPO 1)*

Zyra për Mbrojtje Ndërkombëtare

Korrik 2018